



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.294/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesuese, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Gradanske Inicijative Narodna Pravda, me seli në Lepasaviq, paraqitur kundër Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 04.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pas afatshme ankesa e Subjektit Politik Gradanske Inicijative Narodna Pravda, me seli në Lepasaviq, Anr.294/2025, e datës 01.02.2025, paraqitur kundër Za Slobodu Pravdu Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025,

A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.294/2025 nga Subjekti Politik Gradanske Inicijative Narodna Pravda me seli në Lepasaviq, në të cilën pretendohet se punonjës të Komunës së Lepasaviqit, personat Vladimir Petronijeviq, Darko Vukashinoviç, si dhe kryetari i Kuvendit të Lepasaviqit Gorski Buriq, më 24.01.2025, kanë përdorur automjetin e Nissan, me targa e regj. 3Z 117-18, i cili është në pronësi të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Qeverisë së Kosovës, për vendosjen e materialit zgjedhor të partisë politike, Za Slobodu Pravdu Opstanak. Më tej në ankesë thuhet se në videot e dorëzuara nga qytetarët shihet se personat e lartpërmendur kanë ngjitur material zgjedhor në derën e hyrjes së objektit në rrugën “Dositeja Obradoviça”, pa lejen me shkrim të banorëve të objektit, si dhe në stacionin e autobusëve në Lepasaviq pa leje dhe në vend publik ku shprehimisht është e ndaluar, Veprimet e mësipërme paraqesin shkelje të rëndë të kodit të mirësjelljes së partive politike, ligjit zgjedhor dhe rregullores zgjedhore të miratuar nga KQZ-ja.

Në cilësinë e dëshmisë ju ofrojmë video incizimet dhe fotografitë e dorëzuara nga qytetarët, ku ju ofrojmë:

Si provë ka bashkangjitur fotografi të e automjetit zyrtar Nissan , targa e regj. 3Z 118-17, një fotografi e materialit vendosjes së materialit zgjedhor, materiale në video incizime ku shihen shkeljet e pretenduara.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 04.02.2025, subjekti politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, theksohet se automjeti që i është dhënë Komunës së Leposaviqit, përkatësisht Zyrës së saj për Komunitete, është shfrytëzuar ekskluzivisht për aktivitete të përcaktuara nga ajo zyrë dhe nuk është përdorur për aktivitete të subjektit politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, sepse në asnjë video nuk mund të shihen punëtorë nga komuna e lartpërmendur që vendosin postera apo bartin materiale promovuese, pra e nxjerrin nga vetura.

Më tej në përgjigje theksohet se vendosja e posterave në stacionin e autobusit është objekt publik dhe është në pronësi të komunës së Leposaviqit, e cila i ka lejuar të vendosin materiale propagandistike, ndërsa sa i përket pretendimit se të njëjtit kanë grisur posterat e të tjerëve, nuk ka as dëshmi as foto për veprimin e lartpërmendur dhe se nuk mund të përcaktohet se kush e ka bërë këtë veprim.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesat janë të pas afatshme

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Gradanske Inicijative Narodna Pravda, me seli në Leposaviq, kundër subjektit politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, e datës 01.02.2025, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 01.02.2025, në të cilën ka pretenduar se me datë 24.01.2025 zyrtar të subjekti politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, me seli Graçanicë, kanë përdorur automjetin e Nissan, me targa e regj. 3Z 117-18, i cili është në pronësi të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Qeverisë së Kosovës, për vendosjen e materialit zgjedhor në hapsira publike të partisë politike, Za Slobodu Pravdu Opstanak., që është në kundërshtim me nenin 36, paragrafi 1 të LZP-së, *“Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë*

zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje” si dhe Nenin 34. Paragrafi 1 nën paragrafi 2. “vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtëndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;

Megjithatë, ankesa është paraqitur Gradanske Inicijative Narodna Pravda pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe ankesa është dorëzuar më 01.02.2025, ndërkohë që shkeljet në fjalë janë bërë më 24.01.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli gjeti se ankesa është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 294/2025 më datë 04.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.